



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.12.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Vizitë në Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe në Muzeun Etnografik, Krujë.

2. Vizitë në Muzeun Kombëtar Arkeologjik të Durrësit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Fate Velaj, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

Shoqëruesit:

Mehdi Hafizi – drejtor i Muzeut,

Patriot Beqaraj – drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Sipas kalendarit të punës së komisionit, që e kemi miratuar në mbledhjen e tij, në kuadër të kontrollit parlamentar, sot kemi ardhur për një vizitë punë ne Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, në Krujë.

Pranë nesh kemi drejtorin e Muzeut, z. Mehdi Hafizi, dhe drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës, z. Patriot Beqiraj, dhe natyrisht edhe stafin e Muzeut.

Ne kemi një sërë çështjesh për të cilat duam të diskutojmë me stafin drejtues të Muzeut: si numri i vizitorëve dhe ndikimi i tij në rritjen e të ardhurave të Muzeut, planifikimin e përdorimit të të ardhurave dytësore për nevojat e muzeut, mirëmbajtjen e tij, përshtatja me ligjin e ri të trashëgimisë, marrëdhëniet me pushtetin vendor, marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare dhe mundësitë e binjakëzimit me muze të vendeve të ndryshme, sfidat më të rëndësishme për vitin e ardhshëm etj.

Por, fillimisht, mendoj që të vizitojmë Muzeun.

Vijon vizita nëpër ambientet e Muzeut, ku deputetët shoqërohen nga Drejtori dhe stafi i Muzeut.

Më pas, komisioni vendoset në njërën prej dhomave, ku zhvillon një diskutim me pyetje dhe përgjigje për plotësim të informacionit.

Milva Ekonomi – Në lidhje me të ardhurat që nxirrni nga numri i vizitorëve, që këtë vit, siç na thatë, ka shkuar deri në rreth 60 000 vetë, pra është rritur në krahasim me një vit më parë, a ndikon kjo në rritjen e të ardhurave për Muzeun?

Mehdi Hafizi – Do të ishte mirë nëse do të na kalonte neve një përqindje nga këto të ardhura, të themi jo 90 %, por shumë më pak, do të na ndihmonte shumë, pasi do të na mbulonte, psh., pagesat për faturat e energjisë elektrike, mirëmbajtjen etj., që mos të jemi gjithë kohën në vështirësi e nën presion.

Milva Ekonomi – Pyetja tjetër që kam unë është nëse keni binjakëzim me ndonjë muze jashtë vendit? A funksion binjakëzimi i muzeve?

Mehdi Hafizi – Jo, ne nuk kemi binjakëzim me muze të tjerë jashtë vendit.

Fidel Ylli – Kisha një pyetje, për sa i përket gjithë këtyre vizitorëve që vinë për të parë Muzeun, a akomodohen këtu në Krujë, që të rriten paksa të ardhurat e biznesit, apo largohen për në Tiranë ose Durrës?

Mehdi Hafizi – Po, është rritur numri i vizitorëve që akomodohen këtu, pasi ka familje që vënë në dispozicion dhoma, apo po funksionojnë edhe hostelet. Është me shumë interes, që një pjesë e parave të mbeten këtu. Por përfitohet edhe nga qendrimet ditore apo turizmi shkollor.

Fideli Ylli – Ka shtretër, apo janë në formë hotelesh?

Mehdi Hafizi – Ka hostele, siç thashë, me çmime nga më të ndryshmet dhe vizitorët bëjnë zgjedhjet e tyre sipas interesit.

Fadil Nasufi – Nga prezantimi që na bëtë, që la mbresa te ne të gjithë, për profesionalizmin dhe pasionin që tregoni, a mbani ndonjë lloj historiku në lidhje me personalitetet e veçanta apo të spikatura që vizitojnë Muzeun, se kjo rrit edhe vlerën e tij?

Mehdi Hafizi – Efekti psikologjik është shumë i rëndësishëm për vizitorët. Kishim shumë vizitorë francezë që vinin 2 herë në javë me kroçera. Ky lloj turizmi është i shtrenjtë, francezët po janë francezë dhe fillonim me këtë formë: “do të flasim për këtë personalitet për të cilin ka edhe një shesh në Paris me emrin e tij”, dhe shembuj të tjerë. Skënderbeu zë një vend të rëndësishëm në letërsinë frënge. Po kështu u thoshim se Muzeun e kanë vizituar personalitete, si Bernard Kushner, dhe pas këtyre prezantimeve, ata tregonin më shumë interes për të na ndjekur. Këtë e kemi bërë me shumë kujdes, për të arritur që të tërheqim vëmendjen e vizitorëve. Pra, kjo pjesë është e rëndësishme, për të bërë atë ngacmimin fillestar.

Almira Xhembulla – A i keni të dokumentuara te Libri i Kujtimeve përshtypjet e personaliteteve që kanë vizituar Muzeun?

Mehdi Hafizi – Ai që keni përpara është Libri i Përshtypjeve për delegacionet: janë presidentë, kryeministra, kryetarë delegacionesh. Më parë i shoqëronte një ekip i RTSH-së. Ndërsa tani, me mejtet e reja digjitale është ndryshe. Ndoshta vizitat e tyre mund të gjenden në arkivin e saj. Unë e kam kërkuar edhe me shkrim që të na vihen në dispozicion, pasi të shfaqet në monitor për disa sekonda, p.sh., vizita e Xhorxh Bush-it apo Xhimi Karteirt, e shton atraktivitetin.

Adelina Rista – Me atë krijon arkivin tënd.

Ismeti Beqiraj – Ju luajtët edhe rolin e ciceronit për ne dhe na dhatë informacion tepër interesant; vë re se ciceronët janë shumë të përgatitur, Uroj që komisioni do ta ketë këtë mundësi edhe kur të vijë në Bylis.

Lidhur me pyetjen e ruajtjes së dokumentit historik, të kujtimeve të personaliteteve. Përveç Librit të Shënimeve që është origjinal, po këto materiale që keni, i keni digjitalizuar? Keni ndonjë projekt që jo vetëm dokumentacionin e ri, por edhe të gjitha materialet e tjera të karakterit historik që janë të veçanta, t’ digjitalizoni?

Mehdi Hafizi – Për sa i përket fotografive, po, që kur ka filluar digjitalizimi. Kurse librat, jo vetëm ai për personalitetet, por edhe për vizitorët, janë të gjitha në arkivë.

Ismeti Beqiraj – Ju sa vjet keni që jeni drejtor?

Mehdi Hafizi – Unë jam emëruar drejtor që në vitin 1999.

Ismeti Beqiraj – A ka pasur tentativa vjedhjeje?

Mehdi Hafizi – Jo , edhe në 97-ën, kur kam qenë lektor këtu, edhe ka pasur tentative, por nuk ka humbur gjë.

Nëse keni kohë, mund të kalojmë në Muzeun Etnografik, i cili është më i miri në Ballkan. Edhe atë e mbrojtëm, se atëherë ishte prone private, kurse tani është pronë nën varësinë e Ministrisë së Kulturës.

Ismeti Beqiraj – Te fundit pyetje që kam, por që është e rëndësishme, te ligji që miratuam për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, është siguria fizike e objekteve. Por në aspektin inxhinierik nuk pashë asnjë rrjet për mbrojtjen. Duhet ta ngrini, në projektet e reja, ashtu siç mbrohen arkivat dhe bankat.

Muhamet Bela – Po ju them nja dy fjalë, meqë isha në konferencën kombëtare në Prishtinë, ku kishta disa studiues të huaj, hungarezë, që folën me superlative për Skënderbeun. Institucioni i Kuvendit, komisioni, do të bënte mirë që nëpërmjet Ministrisë së Kulturës apo asaj të Jashtme, të mund të lidhej me këta specialistët e Budapstit, që të kemi mundësi të shkëmbehen përvoja dhe njohuri për Skënderbeun, sepse Huniadi, ka qenë një personalitet i shquar, bashkëkohës i Skënderbeut.

Diskutohet në lidhje me tezat për prejardhjen e nënës së Skënderbeut, Vojsava, ku theksohet ajo e preardhjes shqiptare të saj.

Muhamet Bela – Po të shohim Aleks Buden, Fan Nolin, Kristo Frashërin apo disa studiues kompetentë, ka mendime shumë të ndryshme për këtë çështje.

Milva Ekonomi – Atëherë, në Librin e Përshtypjeve po shkruajmë:

Vizita e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, të legjislaturës IX të Kuvendit, deputetët e grupit të PS mbetën të mrekulluar për profesionalizmin e stafit të Muzeut. Vizita u krye me rastin e Vitit Kombëtar të Skënderbeut, 550-vjetori i vdekjes, krenari kombëtare kjo pjesë e historisë dhe të tregosh me mjeshtëri këtë pjesë të historisë, është jo vetëm pasion, por edhe dije dhe përkushtim. Të gjithëve na bëri përrhytje që faktet e reja bëjnë pjesë në rrëfimin e çdo punonjësi të Muzeut.

Mendoj se duhet të firmosë secili prej jush.

Komisioni viojnë me vizitën në Muzeun Etnografik.

Mbyllet vizita në Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe në Muzeun Etnografik, Krujë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.12.2018, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë në Muzeun Kombëtar Arkeologjik të Durrësit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Fate Velaj, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

Shoqëruesit:

Albert Koni - shef në Muzeun Kombëtar Arkeologjik të Durrësit,
Patriot Beqaraj – drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

Komisioni fillon vizitën e tij në Muzeun Kombëtar Arkeologjik të Durrësit.

Milva Ekonomi – A është kuorumi i nevojshëm për të filluar vizitën në Muzeun Kombëtar Arkeologjik të Durrësit?

Fidel Ylli – Kuorumi është dhe ne mund të vijojmë vizitën tonë në Muzeun Arkeologjik të Durrësit, që është edhe qyteti ku ne të dy jemi deputetë.

Keqardhje për opozitën që në vizitat në këto sajte të mrekullueshme, nuk merr pjesë.

Milva Ekonomi – Na duhet një guide e shpejtë nëpër Muze , që më pas të bëjmë disa pyetje.

Albert Koni - Patjetër, meqë ju doni një guidë të shpejtë, do të përpiqem, megjithatë është e pamundur, të mos vizitojmë të paktën pikat më kyçe, pasi çdo gjë në muze është e vlefshme, e paçmueshme, në kuptimin e thesarit të paçmuar të trashëgimisë kulturore.

Vizita në pavionin e katit të parë të Muzeut, që shoqërohet nga Albert Koni.

Po e fillojmë nga pavioni i katit të parë. Muzeu Arkeologjik ka rreth 3400 objekte. Veçantia e tij është se fillon që nga periudha prehistorike, vijon me periudhën greke, romake. Në katin e dytë pasqyrohen periudhat bizantine dhe otomane.

Vijon vizita e deputetëve në Muze, me shpjegimet e ciceronit.

Ne, nga ana jonë, kemi përmbyllur të gjithë projektin e ekspozimit të objekteve në katin e dytë.

Patriot Beqaraj – Për sa i përket katit të dytë, projekti për muzealizimin e katit të dytë është gati. Ne presim thjeshtë fondet për financimin për ekspozimin e të gjitha objekteve. Periudhat historike që do të ekspozohen në katin e dytë i shpjegoi Berti. Shpresojmë, nga bisedimet që kemi patur, që mund të na financojnë edhe donatorë privatë.

Përsa i përket katit të tretë, atje është një platformë, që i është dedikuar arkeologjisë nënujore. Atje e kemi pak më të thjeshtë punën. Kemi aplikuar në një projekt, ku jemi shpallur fitues. Ai ndoshta mund të përfundojë më shpejt se kati i dytë.

Milva Ekonomi – Po projekti për katin e dytë, sa kushton?

Patriot Beqaraj – Është rreth 42-43 milionë lekë të vjetra.

Vijon guida nëpër muze.

Milva Ekonomi – Të ardhurat dytësore të siguruara nga visitorët, duhet të kalojnë edhe në këto projekte. Të bëhet riinvestim dhe duhet të bashkëpunohet edhe me bashkinë përkatëse. Po bëj përmbledhësen, jo si deputete e Durrësit, por si ajo që bëra vizitën bashkë me ju. Dhe ajo më e rëndësishmja, që ne po e vëmë re në fakt, nëpër muze, i kemi ciceronët, përgjegjësit, drejtorët shumë të përgatitur, sepse në fakt jemi prekur nga mënyra se si paraqisni.

Fideli Ylli – Doja të dija se si ka qenë fluksi i turizmit këtë vit.

Albert Koni – Ne jemi në kuotat e një rritjeje të jashtëzakonshme të numrit të turistëve për këtë vit. Jemi 60 % krahasuar me një vit më parë.

Ismeti Beqiraj – Po me të ardhurat nga vizitorët?

Albert Koni - Këta janë vizitorë me pagesë, bileta është 300 lekë të reja në Muze dhe 200 lekë të reja në anfiteatër.

Kemi një propozim, që duke parë fluksin e madh që patëm këtë vit, pretendojmë të rrisim pak çmimin e biletës, si në muze, ashtu dhe në anfiteatër.

Patriot Beqiraj – E kemi bërë këtë propozim dhe i kemi shtuar guidës edhe 2 objekte të tjera që janë Forumi bizantin dhe Termat romake. Pra, kur merr një biletë për muzeun, viziton edhe këto të dyja.

Milva Ekonomi – Pra, janë brenda në paketë.

Almira Xhembulla - A keni ju publikime në letër?

Albert Koni – Sigurisht ne kemi broshurat tona, si për Muzeun, ashtu dhe për anfiteatrin.

Ju faleminderit për vizitën.

Mbyllet vizita e Komisionit në Muzeun Arkeologjik të Durrësit.